REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI

Adresa:rr."Adem Jashari" pn, kk.rks-gov.net/gjilan, info.gjilan@rks-gov.net tel.0280 320 781, 0280 320 782, 321 482, 321 483

Në mbështetje të nenit 37 paragrafi 1.1, nenit 38 paragrafi 1.4 dhe nenit 46 pararagrafi 2.3 të Statutit të Komunës së Gjilanit 01. nr. 16-126211 dt. 06.11.2014, dhe në zbatim të Rekomandimit të Komitetit për Zhvillim Ekonomik 01.nr.08/2015 të datës 23.01.2015, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në mbledhjen e mbajtur me 27.01.2015, merr:

V E N D I M
për subvencionimin e normës së interesit për kredit e bizneseve mikro dhe agro

1. Me këtë vendim Komuna e Gjilanit mbështet zhvillim e qëndrueshëm të ekonomisë lokale përmes financimit (subvencionimit) të normës së interesit për kredit e bizneseve mikro dhe agro.

2. Shuma totale e interesit bankar e cila financohet nga Komuna e Gjilanit për bizneset mikro dhe ago arrin vlerën 150,000.00 € dhe do të ndahet për çdo vit nga 50,000.00€

3. Komuna e Gjilanit nuk merr përgjegjësi për riskun e kredisë dhe kamatën ndëshkuese, ndërsa kriteret për përzgjedhjen e bizneseve të cilave Komuna u financon normën e interesit, mbesin përgjegjësi e bankës përkatëse.

4. Mjetet financiare për subvencionimin-financimin e normës së interesit për kredit mikro dhe agro ndahen nga subvencionet e Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik dhe Drejtorisë për Bujqësi dhe Pylltari.

5. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Drejtoria për Bujqësi dhe Pylltari ndërsa për monitorim të zbatimit kujdeset Kryesuesi I KK-Gjilan.

6. Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së dhe publikimit në gjuhët zyrtare në ueb faqen e Komunës,

01.Nr. 016-9259
Gjilan, më 27.01.2015

Kryesuesja e Kuvendit,
_____
Valentina Bunjaku-Rexhepi